



**Datë:** 09.06.2025

**Numër Protokolli:** 3984/2025

**A.nr.614/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj–Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.614/2025 të datës 08.04.2025 të parashtruar nga ankuesja D.A, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.614/2025, e datës 08.04.2025, e parashtruar nga ankuesja D.A.

**II. Mbetet në fuqi** Njoftimi me numër protokolli 02-016-19654, i datës 11.03.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën *Zyrtar i Lartë për Prokurimit*.

## A r s y e t i m

Kandidatja për praninë në shërbimin civil, D.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 08.04.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2305/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër për procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016278, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë i Prokurimit*”, në Komunën e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit, më datë 22.04.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 3259/2025, të datës 19.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.614/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2305/2025 të datës 08.04.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me numër protokolli 02-016-14602 të datës 21.02.2025; Konkursin me numër reference RN00016278, të datës 10.01.2025; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Pasqyrën e notave me numër protokolli 2252/55-30 të datës 11.03.2024; Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 187, të lëshuar me datë 08.05.2018 nga Universiteti Publik “Kadri Zeka”-Fakulteti Ekonomik në Gjilan; Certifikatën e datës 24.05.2013; CV-n e ankueses; Referencën e datës 31.12.2021, të lëshuar nga “Gama” Sh.P.K; Referencën e lëshuar nga N.T.P “Jona”; Vërtetimin me Nr.06/5164 të datës 15.03.2013; Vërtetimin me Nr.03-1928/16 të datës 27.06.2016; Referencën e datës 25.04.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 22.04.2025; Aprovimin për shpalljen me numër protokolli 02 Nr.18 të datës 09.01.2025; Vendimin me numër protokolli 02 Nr.309 të datës 05.03.2025, lidhur me themelimin e Komisionit të Pranimit; Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin me numër protokolli 02-016-14973 të datës 24.02.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë dhe esesë; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin me numër protokolli 02-016-19654, të datës 11.03.2025; Aplikacionin e ankueses të datës 16.01.2025, së bashku me dokumentet e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit A.Sh, të datës 06.02.2025, së bashku me dokumentet e bashkangjitura për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Gjilanit, më datë 10.01.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00016278, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë Prokurimit*-Klasa Profesional 1, me afat aplikimi nga data 11.01.2025 deri me datë 09.02.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 24 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa prej tyre 5 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, ndërsa ankueses përmes Vendimit me numër protokolli 02-016-14602 të datës 21.02.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk posedon së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale, ndërsa prej tyre 5 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur.

Tutje, përmes Njoftimit me numër protokolli 02-016-19654, i datës 11.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të organit përkatës të punësimit, rezulton se kandidati A.Sh, me gjithsejtë 97.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidat fitues për pozitën *“Zyrtar i Lartë për Prokurimit”* në Komunën e Gjilanit.

Ankuesja, kundër zhvillimit të kësaj procedure rekrutimit ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore se refuzimi i aplikacionit të saj ka ndodhur në mënyrë të padrejtë, duke shtuar se ka dyshime të bazuara mbi transparencën dhe paanshmërinë e këtij procesi të rekrutimit, andaj e nëjtja kërkon që rishqyrtohet vendimi mbi refuzimin e aplikacionit, hetimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatit si dhe transparencë dhe publik të kritereve objektive mbi të cilat është përzgjedhur kandidati fitues.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00016278, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Prokurimit, Klasa Profesional 1, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor): Ekonomi (pavarësisht nga specializimi), Juridik apo Administratë Publike; Kërkesat Specifike: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankueses si më sipër, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion,*; dhe se po ashtu sipas shpalljes së konkursit të datës 28.10.2024 të gjithë kandidatet kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, duke përfshi këtu edhe: *Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në*

*vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, gjegjësisht aplikacionit të punësimit të ankueses, së datës 16.01.2025, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.187, të lëshuar me datë 08.05.2018, nga Universiteti Publik “Kadri Zeka”, përmes të cilës dëshmohet se e njëjta më datë 23.03.2018, ka mbaruar studimet në Fakultetin Ekonomik, duke fituar titullin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës ankuesja ka bashkangjitur Referencën e datës 25.04.2024, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mbi të cilën dëshmohet se e njëjta nga data 05.12.2022 deri më 05.12.2023, ka qenë e angazhuar në Departamentin e Administratës Pensionale- Zyra Regjionale në Gjilan, dhe atë në kryerjen e detyrave të punës si: *pranimin e kërkesave të të gjithave skemave pensionale, protokollimin e lëndëve, shpërndarjen e vendimeve, sistemimin e arkivave Bazë dhe P.P.A.K, skenimin e lëndëve si dhe të gjitha punët në Administratën Pensionale*; Referencën e lëshuar nga “Gama” Sh.P.K, përmes së cilës dëshmohet se e njëjta nga data 01.10.2018 deri 31.12.2021, ka qenë e angazhuar në pozitën *Shitëse dhe Arkëtare*, për të cilën përvojë pune në sektorin privat e njëjta ka bashkangjitur edhe Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensionale, kurse sa i përket Referencës së lëshuar nga NTP “JONA”, përmes së cilës theksohet se nga data 03.01.2022 deri 01.07.2022, ankuesja ka qenë e angazhuar *në punën praktike si agjente doganore*, për të cilën përvojë pune e njëjta nuk ka bashkangjitur dëshmi siç kërkohet me shpalljen e konkursit përkatës, sepse e njëjta përvojë pune në sektorin privat nuk figuron në kontributet e Pasqyrës së Llogarisë së Trustit Pensional; ndërsa lidhur me Vërtetimin me numër protokolli 03-1928/16 të datës 27.06.2016, të lëshuara nga Posta e Kosovës Sh.A *për periudhën e praktikës nga data 26.05.2016 deri më 25.06.2016*, si dhe Vërtetimin me Nr.06/5164 të datës 15.03.2013, të lëshuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për praktikën nga data 01.02.2013 deri më 15.03.2013, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Gjilanit, përkitazi me këtë përvojë pune para diplomimit apo para datës 23.03.2018 Kolegji i Këshillit duke u bazuar në praktikën vendimmarrëse dhe të konfirmuar sipas Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/18 të datës 19.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se në rastet kur kërkohet përvojë pune profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit, ndaj edhe përmes këtyre vërtetimeve konstatohet se përvoja e punës ankueses para diplomimit nuk është përvojë pune profesionale.

Mirëpo, pavarësisht kësaj përvoja e dëshmuar e ankueses tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe tek punëdhënësi “GAMA” Sh.P.K, nuk përkon me përvojën e punës profesionale dy (2) vjeçare, në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, gjegjësisht në fushën e Prokurimit, ashtu siç është kërkuar me shpalljen e konkursit të datës 10.01.2025, ngase e njëjta bazuar në shkresat e sapo theksuara posedon përvojë vetëm në fushën administrative, të shitëses dhe arkëtares, që nuk nënkupton përmbushjen e këtij kriteri të sipër theksuar, ndaj si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit me Vendimin me

numër protokolli 02-016-14602 të datës 21.02.2025, mbi të cilin akt ankueses i ka refuzuar aplikacionin ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi;* ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të këtij Ligji.

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe procedurës përkatëse të rekrutimit, ka analizuar dosjen e kandidatit fitues A.Sh, i cili nga kjo procedurë rekrutimi ka arritur gjithsejtë 97.4 pikë të përgjithshme, respektivisht 67.4 pikë nga testi me shkrim dhe 30 pikë nga intervista me gojë, ku konstatohet se i njëjti me rastin e aplikimit për konkursin përkatës me prova konkrete ka dëshmuar se plotëson kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara si më sipër, sepse sa i përket plotësimin të kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.180/12 të lëshuar me datë 30.05.2012, nga Kolegji AAB-RIINVEST, përmes së cilës konstatohet se i njëjti me datë 21.03.2012, ka mbaruar studimet në Programin Menaxhment dhe Informatikë, duke fituar kështu titullin Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë, ndërsa sa i përket plotësimin të kriterit prej së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, kandidati në fjalë ka bashkangjitur Vërtetimin me numër protokolli 02 Nr.228 të datës 06.02.2025, përmes së cilit dokument dëshmohet se i njëjti nga data 19.09.2022 e tutje, është i punësuar në pozitën e Zyrtarit të Prokurimit në Komunën e Gjilanit, apo përafërsisht 2 vite e 5 muaj, ndaj si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidat fitues, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Kolegji i Këshillit, duke bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës, ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit me numër protokolli 02-016-19654, të datës 11.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën “Zyrtar i Lartë për Prokurimit”, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 02-016-19654, i datës 11.03.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën “Zyrtar i Lartë për Prokurimit”, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.614/2025**

**Atdhe GASHI**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

---

Procesmbajtës

---

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses D.A;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.